

VENDIM
Nr.423, datë 21.3.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK VENDOR “OXYGEN”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” të “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” miratuar me vendimin nr.162 të KKRT-së, të vendimit nr.404, datë 30.11.2005 të KKRT-së, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.041/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë, subjektin “Radiolink”, sh.p.k. për radion “Oxygen”.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 17.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj